

Con il patrocinio di:



Presidenza del Consiglio dei Ministri
Dipartimento per le Pari Opportunità



Ministero degli Affari Esteri



Ministero dell'Interno



Ministero del Lavoro, della Salute
e delle Politiche Sociali



Regione Lazio
Assessorato alle Politiche Sociali



Croce Rossa Italiana

Carta dei valori della cittadinanza e dell'integrazione

Edizione plurilingue
a cura di Progetto ImmigrazioneOggi-ONLUS
- Versione in Albanese -

Realizzata per gli Enti e le Imprese che aderiscono all'iniziativa 2008-2009

La Conoscenza per l'Integrazione



l'Integrazione per la Sicurezza

Con il sostegno di:

 Studio.
immigrazione

 I
interpreti
traduttori
consorziati

 ASSOCIAZIONE NAZIONALE
FUNZIONARI DI POLIZIA



PREZANTIMI

Karta e vlerave të shtetësisë dhe e integritit, lind si një rrugë e drejtuar nga Ministri i Brendshëm, Giuliano Amato, në gjysmën e dytë të 2006-ës, në kuadrin e iniciativave të drejtuara integritit dhe kohezionit social.

Objektivi është ai, që të vë në dukje vlerat dhe përparimet e vlefshme për të gjithë ato të cilët, dëshirojnë të banojnë stabilisht në Itali, të çdo lloj grupi ose komuniteti të natyrës kulturore, etnike ose fetare në të cilin bëjnë pjesë.

Me 13 tetor 2006, me dekretin e Ministrit të Brendshëm u emërua Komiteti shkencor i cili u ngarkua me detyrën e formimit të Kartës së vlerave, në këtë kompozim bënin pjesë:

Profesoresha Roberta Aluffi Beck Peccoz (Universiteti i Torinos), Profesor Carlo Cardia, me funksionin e koordinatorit (Universiteti Roma Tre), Debutet dhe Profesor Khaled Fouad Allam (Universiteti i Triestes), Profesor Adnane Mokrani (Universiteti Gregorian i Romës), Profesor Francesco Zannini (Istituti Papnor i studimeve arabe dhe izlamike të Romës). Kanë marrë pjesë në formimin e Komitetit shkencor, Prefekti Franco Testa dhe nën Prefekti Maria Patrizia Paba.

Komiteti shkencor, ka zhvilluar konsultime të zgjeruara duke takuar shoqata dhe organizime në botën e imigrimit dhe fesë, sociale, sindikaliste dhe të bamirësisë, komponentet e Konsultës për Islamizmin italian dhe të Konsultës të rinjve përsa i përket çështjeve relative me pluralizmin kulturor dhe fetar, ekspertët dhe eksponentët e Istitucioneve.

Karta e vlerave të shtetësisë dhe e integritit, që u lidh ngushtësisht me Kushtetutën italiane dhe me Kartat evropiane dhe internacionale mbi të drejtat humane, ka një karakter esencial programatorë për aksionin e Ministrisë së Brendshme, e cila dëshiron të prezantojë një instrument të nevojshëm për individët e imigrimit, për komunitetet fetare, për qytetarët italian, mbi të gjitha për të rinjtë, për të përhapur një njohuri sa më të mirë mbi problemet e imigrimit dhe të lirisë fetare.

Karta e vlerave u prezantua zyrtarisht nga Ministri i brendshëm me 23 prill 2007.

ITALIA, KOMUNITET I PERSONAVE DHE I VLERA VE

Italia, është një nga Vendet më antike të Evropës dhe rrënjët e saj ndodhen në kulturën klasike të Greqisë dhe Romës. Ajo, eci përpara në horizontin e krishtërimin dhe ka përshkuar historinë e saj, së bashku me hebraizmin, ka përgatitur hapjen drejt modernizimit dhe të parimeve të lirisë dhe drejtësisë.

Vlerat, në të cilat themelohet shoqëria italiane, janë frut i punës brez pas brezi të burrave dhe grave me orientime të ndryshme, laike dhe fetare dhe janë të shkruara në Kushtetutën demokratike të 1947-ës. Kushtetuta paraqit një vijë ndarëse kundrejt totalitarizmit dhe të antisemitizmit, e cila ka helmuar të gjithë Evropën e shekullit XX dhe ka ndjekur popullin hebraik dhe kulturën e tij.

Kushtetuta është e themeluar në bazë të rrespektit dhe dinjitetit human dhe është e frymëzuar nga parimet e lirisë dhe barazisë të vlefshme për çdokush, që jeton në territorin italian. Duke u nisur nga Kushtetuta, Italia ka marrë pjesë në ndërtimin e Evropës së bashkuar dhe të institucioneve të saj. Traktatet dhe Marrëveshjet evropiane ndihmojnë në realizimin e një rregulli internacional të bazuar mbi të drejtat humane dhe mbi barazinë dhe solidaritetin midis popujve.

Pozicioni gjeografik i Italisë, tradicioni hebraik-katolik, institucionet e lira dhe demokratike që e udhëheqin, janë në qendër të qëndrimit të saj të mikpritjes drejt popujve të tjerë. E zhytur në Detin Mesdhetar, Italia ka qenë gjithmonë udhëkryq i popujve dhe kulturave të ndryshme dhe popullsia e saj prazanton akoma sot shenjat e këtij ndryshimi.

E gjithë kjo, krijon pasurinë e Italisë, bukuritë e saj artistike dhe natyrore, burimet ekonomike dhe kulturore, institucionet e saj demokratike janë në shërbim të burrave, grave dhe të rinjve dhe të brezave të ardhshëm. Karta jonë kushtetuese, mbron dhe shtyn përpara të drejtat humane të patjetërsueshme, për të përkrahur personat më të dobët, për të garantuar zhvillimin e aftësive dhe prirjeve në punë, moral, shpirtëror të çdo personi.

DINJITETI I NJERIUT, TE DREJTAT DHE DETYRAT

1. Italia është e angazhuar, sepse çdo njeri nga momenti i parë, në të cilin ndodhet në territorin italian mund të shfrytëzojë të drejtat themelore, pa dallim seksi, etnie, feje ose kushte sociale. Në të njëjtën kohë, çdo njeri, që jeton në Itali duhet të rrespektojë vlerat në të cilat mbështetet shoqëria, të drejtat e të tjerëve, detyrat e solidaritetit të kërkuara nga ligjet. Në kushtet e parashikuara nga ligji, Italia ofron azil dhe mbrojtje atyre, të cilëve në vendet e tyre janë të ndjekur ose të ndaluar në ushtrimin e lirisë themelore.

2. Në parashikimin e barazisë të drejtave dhe të detyrave për të gjithë, ligji ofron mbështetjen e tij, për ato të cilët pësojnë diskriminime, ose jetojnë në një gjendje nevojë, grave dhe fëmijëve, duke lëvizur pengesat që ndalojnë zhvillimin e plotë të një personi.

3. Të drejtat e lirisë dhe të drejtat sociale, që sistemi ynë ka zhvilluar në kohë duhet t'u zgjerohen të gjithë imigrantëve. Është e garantuar e drejta e jetës nga fillimi deri në përfundimin natyral të saj, dhe të drejtën e shëndetësisë me kurime pa pagesë kur janë të nevojshme; një mbrojtje speciale është e siguar për fëmijërinë dhe shtatëzaninë. E drejta e studimit është e njohur si një instrument i domosdoshëm për rritjen personale dhe hyrjen në shoqëri.

4. Burri dhe gruaja kanë dinjitet të njëjta dhe të drejta të njëjta brenda dhe jashtë familjes. Grave, burrave dhe të rinjve imigrantë, Italia i ofron një oxhak integrimi rrespektues të identiteteve të secilit, dhe të sjellë ata që zgjedhin stabilizimin në Vendin tonë që të marrin pjesë aktivisht në jetën sociale.

5. Imigranti, sipas kushteve të parashikuara nga ligji, mund të bëhet qytetarë italian. Për të marrë shtetësinë në kohën e parashikuar nga ligji nevojitet njohje e gjuhës italiane dhe elementet esenciale të historisë dhe kulturës nacionale dhe të jenë dakort me parimet, që formojnë shoqërinë tonë. Të jetosh në të njëjtën tokë do të thotë që të jesh plotësisht qytetarë, me besnikëri dhe koherencë, vlerat dhe përgjegjësitë e njëjta.

TE DREJTAT SOCIALE, PUNA DHE SHENDETI

6. Italia, mbron dhe vlerëson punën në të gjitha aspektet e saj, dënon dhe lufton çdo formë të shfrytëzimit njerëzor, në mënyrë të veçantë atë të grave dhe të fëmijëve. Puna favorizon zhvillimin e njeriut dhe realizimin e vetëtive dhe aftësive natyrale.

7. Imigranti, si çdo qytetarë italian, ka të drejtën e një shpërblimi të përshtatshëm për punën e zhvilluar, për derdhjen e kontibuteve për shëndetin dhe sigurimet shoqërore, shikimin e garantuar të pushimit në rast sëmundjeje ose aksidenti dhe në moshë të vjetër në kushtet e parashikuara nga ligji.

Cdo punë duhet të kryhet në kushte të sigurta për shëndetin dhe paprekshmërinë e personit.

8. Kushdo që është objekt dhune, diskriminimi, ose shfrytëzimi në vendin e punës mund t'i drejtohet autoriteteve publike, organizatave sindikale, sociale dhe të asistencës, për të parë të rrespektuar të drejtat e tyre dhe për të mund të zbatuar detyrën e tyre me rrespektin e dinjitetit njerëzor.

9. Qytetarët italian dhe imigrantët kanë të drejtën e kurave në strukturat publike.

Trajtimet shëndetësore janë të kryera në rrespektin e vullnetit të personit, të dinjitetit të tij duke marrë parasysh ndjeshmërinë e secilit. Është i dënuar çdokush, i cili ushtron prerjen e një pjese trupi pa nevojshmërinë mjekësore.

10. Italia është e angazhuar, që të gjithë të jetojnë në banesa të përshtatshme për nevojat familjare dhe me kushte të llogjikshme. Kush ndodhet në gjendje nevoje ose është i detyruar, që të paguaj shuma të larta parash për banesën e tij, mund t'i drejtohet autoriteteve publike ose shoqatave sindikale për të marrë asistencë dhe për të rrespektuar të drejtat e tij.

TE DREJTAT SOCIALE SHKOLLA, ARSIMI, INFORMACION

11. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë dhe si detyrë që të frekuentojnë shkollën e detyrimit, për të pasur të njëjtat të drejta në shoqëri dhe që të bëhen subjekte aktiv. Është detyrë i çdo prindi italian ose i huaj, të mbajnë fëmijët me studime, si pikë e parë duke i rregjistruar në shkollën e detyrueshme, e cila fillon me shkollën fillore deri në 16 vjeç.

12. Mësimi është i drejtuar formimit të personit dhe vlerëson njohjen e të drejtave themelore dhe edukimin e ligjshmërisë, lidhjet miqësore mes njerëzish, respekt dhe mirëdashje drejt çdo forme të jetës që ekziston. Edhe për të favorizuar ndarjen e të njëjttave vlera, shkolla parashikon programe për njohjen e historisë dhe kulturës dhe gjithashtu, parimet e tradicioneve italiane dhe evropiane. Për një mësim të përshtatshëm për pluralizmin e shoqërisë, është esenciale në një perspektivë ndërkulturore, ku vlerësohet njohja e kulturës dhe e fesë, në të cilën fëmijët dhe prindërit bëjnë pjesë.

13. Shkolla vlerëson njohjen dhe integrimin e fëmijëve mes tyre, mos paragjykimin dhe rritjen e njëjtë të të rinjve duke shmangur çdo ndarje dhe diskriminim. Mësimi bëhet në respekt të opinjoneve fetare ose idealeve të fëmijëve dhe familjeve, dhe në disa kushte të caktuara parashikon kurse fetare të zgjedhura vullnetarisht nga nxënësit dhe prindërit e tyre.

14. Në bazë të të njëjttave vlera, i përket edhe mjeteve informative që të favorizojnë njohjen e imigrimit, të komponenteve të saj kulturore dhe fetare, duke ju kundërvënë paragjykimeve dhe ksenofobisë. Roli i tyre është esencial për përhapjen e një pluralizmi kulturor respektues i traditave dhe i vlerave kryesore të shoqërisë italiane.

15. Është e garantuar e drejta e enteve dhe e privatëve, që mund të zëvendësojnë shkollat ose kurset shkollore, mjaft që të mos diskriminojnë nxënësit për arsye etnie ose konfesionale, dhe sigurojnë një mësim në harmoni me parimet e përgjithëshme të arsimit dhe të drejtat njerëzore, që u përkasin personave. Cdo lloj mësimi i kryer qoftë në një shkollë private ose shtetërore, duhet të respektojë bindjet e secilit dhe t'i afrohet bashkimit të njerëzve dhe jo ndarjes së tyre.

FAMILJA, BREZAT E RINJ

16. Italia njeh të drejtat e familjes si një shoqëri natyrore e formuar nga martesë, dhe konsideron edukimin familjar një mjet të nevojshëm për rritjen e brezave të rinj.

17. Martesa është e bazuar mbi barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisë midis bashkëshortit dhe bashkëshortes dhe për këtë që struktura e saj është monogamike. Monogamia bashkon dy jetë dhe i bën të përgjegjshëm për atë që rrealizojnë së bashku, duke filluar nga rritja e fëmijëve. Italia nuk lejon poligaminë sepse është kundër të drejtave të gruas, në akord me parimet e miratuara nga institucionet evropiane.

18. Rregulli italian ndalon çdo formë dhune brenda dhe jashtë familjes, dhe mbron dinjitetin e gruas në të gjitha drejtimitet e saj dhe në çdo moment të jetës shoqërore. Baza e bashkimit martesor është liria martesore dhe i përket të rinjve, e cila sjell ndalimin e martesave me dhunë dhe gjithashtu mes fëmijësh.

19. Italia, mbron të drejtat e minoreneve në zhvillimin e personalitetit të tyre, i cili formohet edhe në takimin me të rinjtë e tjerë, dhe në marrjen pjesë të aktiviteteve sociale. Parimi i barazisë nuk është i bashkueshëm me pretezat e ndarjes, për arsyen e përkatjes konfesionale, burra dhe gra, vajza dhe djem, në shërbimet publike dhe në zbatimin e aktiviteteve të punës.

LAICITETI DHE LIRIA FETARE

20. Italia është një Vend laik i themeluar mbi njohjen e lirisë së plotë fetare individuale ose kolektive. Liria fetare i njihet çdo personi, qytetarë italian ose i huaj dhe komuniteteve fetare. Feja dhe bindja fetare nuk mund të jenë arsye diskriminimi në jetën sociale.

21. Të gjitha rrëfimet fetare janë në të njëjtën mënyrë të lira para ligjit. Shteti laik njih përkrahjen pozitive që feja i dhuron kolektivitetit dhe mendon që të valorizojë pasurinë morale dhe shpirtërore të secilës prej tyre. Italia favorizon dialogun ndërfaqet dhe ndërkulturor për të rritur rrespektin e dinjitetit njerëzor dhe të përkrahë mbikalimin e paragjykitimit dhe intolerancës. Kushtetuta parashikon akorde midis Shteteve dhe rrëfimeve fetare për të rregulluar kushtet e tyre juridike më specifike.

22. Parimi i të drejtës dhe të drejtat e njeriut nuk mund të shken në emër të asnjë feje. Është e ndaluar çdo formë dhune, nxitjeje për dhunë e motivuar nga feja. Ligji civil dhe penal është i njëjtë për të gjithë, pavarësisht nga feja e secilit, dhe e vetmja është vendimi i gjykatave për atë njeri i cili ndodhet në territorin italian.

23. Liria fetare dhe e ndërjegjes përfshin të drejtën e pasjes së një besimi fetar, ose të mos pasjes, të jesh praktikant ose jo, të ndërrimit të fesë, të përhapjes së saj duke bindur të tjerët dhe të bashkimit në organizata rrëfyese. Është plotësisht e garantuar liria e kultit dhe kushdo mund të kryej pararregjistrime fetare mjafton që të mos jenë në kundërshtim me format penale dhe me të drejtat e të tjerëve.

24. Rendi mbron lirinë e kërkimit, të kritikës dhe të debatit, edhe në lëndën e fesë dhe ndalon ofendimin drejt fesë dhe ndjenjës fetare të njerëzve. Për ligjin e Shtetit, diferenca e fesë dhe e bindjes nuk është një pengesë për martesën.

25. Duke pasur parasysh tradicionin e saj fetar dhe kulturor, Italia rrespekton simbolet dhe shenjat e të gjitha feve. Asnjë nuk mund të mbetet i ofenduar nga shenjat fetare ndryshe nga ato të fesë së tij. Siç është stabilizuar nga Kartat internacionale, është i drejtë edukimi i të rinjve për rrespektimin e bindjeve fetare të tjerëve, pa parë në ato faktorë të ndarjes së qenies njerëzore.

26. Në Itali nuk ka detyrime përsa i përket veshjes së personit, mjafton që të jetë lirisht e zgjedhur nga vetë personi dhe jo dëmtues për dinjitetin e tij. Nuk janë të pranueshme format e veshjes të cilat mbulojnë fytyrën, sepse ky fakt nuk lejon identifikimin e personit dhe e pengon në hyrjen e rraportit me të tjerët.

ANGAZHIMI INTERNACIONAL I ITALISE

27. Në koherencë me këto parime Italia kryen në botë një politikë me paqe dhe me rrespekt për të gjithë popujt, për të përkrahur bashkëjetesën mes gjithë nacioneve, për të mundur luftën dhe terrorizmin. Italia është e angazhuar në fushën internationale për të mbrojtur pasurinë e jetës, të ambjentit dhe të planetit.

28. Italia hedh poshtë luftën, si instrument i zgjidhjes së mosmarrveshjeve internationale, armët e shkatërrimit total, dhe çdo formë të torturës ose të poshtërimit për dinjitetin njerëzor. Ajo dënon antisemitizmin, që ka sjellë në gjenocidin e popullit hebraik dhe çdo tendencë raciste që kërkon të ndajë njerëzit dhe të ulë më të dobtit. Italia rrefuzon të gjitha manifestimet e ksenofobisë, që shprehen herë pas here në izlamofobinë ose në paragjykitime drejt popujve që vijnë nga anët e tjera të botës.

29. Së bashku me Vendet e tjera evropiane, Italia ka hequr dënimin me vdekje dhe punon në pikat internationale, sepse të hiqet në të gjithë botën. Heqja e dënimit me vdekje do të vendoste një arritje të qytetërimit, që vë në dukje rrespektin e jetës mbi shpirtin e hakmarrjes.

30. Italia është e angazhuar, që të zgjidhë paqësisht krizat kryesore internationale, në veçanti konfliktin e izraelo-palestinës që zgjat nga shumë kohë. Angazhimi i Italisë është gjithmonë për një solucion që i shikon të jetojnë bashkë popujt, në vend të parë izraelianët dhe palestinezët në kontekstin e dy Shteteve dhe dy demokracive.

31. Së bashku me Vendet e tjera evropiane, Italia vepron në nivel internacional dhe përkrah kudo rrespektin e dinjitetit dhe të drejtave njerëzore, dhe për të favorizuar miratimin e demokracisë politike, si formë Shteti që lejon pjesëmarrjen e qytetarëve të shtetit të gjësë publike dhe të rrespektit në rritje të drejtave të njeriut.

Traduzione di Dorina Stafa